



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 tetor 2017
Nr. ref.: RK 1128/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI77/16

Parashtrues

Burim Ramadani dhe Arsim Ramadani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 296/2015, të 10 shkurtit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Burim Ramadani dhe Arsim Ramadani (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës). Ata përfaqësohen nga Vahide Braha, avokate nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 296/2015, të 10 shkurtit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesve, janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 18 maj 2016, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 14 qershor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 23 qershor 2017, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.
8. Më 6 shtator 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Procedura fillestare

9. Në vitin 2011, parashtruesit e kërkesës u shpallën fajtor në instancën e fundit dhe u gjykuan me dënim me burg për veprën penale të vrasjes së pesë anëtarëve të familjes H.
10. Më 13 qershor 2011, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesën KI81/11 për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, P. nr. 162/2003, të 7 prillit 2005 dhe aktgjykimeve të Gjykatës Supreme (Ap. nr. 393/2006, të 20 majit 2008), (Ap. nr. 04/2009, të 16 shtatorit 2009) dhe (PKL. nr. 30/2010, të 1 shkurtit 2011).

11. Në kërkesën KI81/11, parashtruesit e kërkesës pretenduan se me aktgjykimet e kontestuara janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara nga nenet 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës, si dhe nga neni 5 (1), neni 6 (1) dhe (2) dhe neni 14 të KEDNJ-së.
12. Më 15 maj 2012, Gjykata Kushtetuese e Kosovës me Aktvendimin KI81/11, pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, konstatoi se kërkesa është qartazi e pabazuar dhe e refuzoi kërkesën si të papranueshme.

Përsëritja e procedurës

13. Në një datë të pacaktuar, parashtruesit e kërkesës, përmes avokatit të tyre, paraqitën kërkesën për rishikimin e procedurës penale në të cilën kishin kërkuar administrimin e provave të reja dhe ekspertizën e sërishme të të dhënave të telefonave celularë të parashtruesve të kërkesës.
14. Më 4 shtator 2015, Gjykata Themelore në Gjilan (me Aktvendimin P. nr. 162/03), e hodhi poshtë si të palejuar kërkesën për ekspertizën e sërishme të të dhënave të telefonave celular të parashtruesve të kërkesës. Njëkohësisht, Kolegji refuzoi edhe kërkesën për administrimin e provave të reja, me arsyetimin se:

“Kolegji i kësaj gjykate pas vlerësimit të kërkesës së mbrojtjes së të dënuarve Burim dhe Arsim Ramadani, përgjigjes së prokurorisë së shtetit si dhe kërkimeve të saja gjeti se kërkesa duhet të hidhet si e palejuar për shkak se faktet dhe provat nuk ofrojnë arsye për lejimin e rishikimit të procedurës ngase të njëjtat janë kërkesa të ripërsëritshme të mbrojtjes dhe janë konsumuar me aktgjykimet e mëhershme”.

15. Parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta pranojë ankesën si të bazuar, ashtu që lënda të kthehet në rivendosje ose që vendimin e shkallës së parë ta ndryshojë dhe Gjykata e Apelit të vendosë për meritat e kërkesës.
16. Më 26 tetor 2015, Prokuroria e Apelit në Prishtinë (me parashtruesen PPN/I. nr. 167/15) propozoi që të refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruesve dhe të vërtetohet aktvendimi i kontestuar.
17. Më 30 dhjetor 2015, Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën (Aktvendimi PN. nr. 582/15). Gjykata e Apelit arsyetoi se, *“refuzohet si e pabazuar ankesa [...] e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore [...] ndërsa sipas detyrës zyrtare, ndryshohet aktvendimi i ankimuar, ashtu që, kërkesa [...] për rishikimin e procedurës penale, e përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm [...] refuzohet në tërësi si e pabazuar”.*
18. Parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, në të cilën kanë theksuar se gjykatat *“kanë injoruar çështjen e alibisë së të dënuarve, në të cilin drejtim janë prezantuar edhe*

provat konkrete, të cilat do të duhej të administroheshin në procedurën e përsëritur. Vendimet e të dy gjykatave janë arbitrare sepse nuk u vlerësuan provat e prezantuara të cilat në kërkesë potencohen si të reja”.

19. Më 10 shkurt 2016, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Pml. nr. 296/2015), e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Gjykata Supreme arsyetoi se:

“Në rastin konkret nuk janë paraqitur prova të cilat në kuptim me dispozitën e lartcekur do të konsideroheshin si të reja, për t’u lejuar rishikimi i procedurës ndërsa, fakti se tani janë gjetur dëshmitarë të rinj, me dëshmitë e vjetra të cilat janë konsumuar gjatë procedurës penale në të gjitha instancat, është irrelevant sepse në rastin konkret dëshmitë e ofruara lidhur me alibinë e të pandehurve në asnjë variant nuk mund të ndikojnë në aplikimin e ndonjë dispozite apo, paragrafi më të lehtë nga ai në bazë të të cilit të dënuarit janë shpallur fajtor, për faktin se çështja e alibisë është vlerësuar në aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të shkallës së dytë dhe atë të tretë, prandaj pretendimet e mbrojtësit qartazi dalin si të pabazuara”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesit së pari i përsërisin të njëjtat pretendime të cilat i theksuan edhe në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, dhe atë: (a) se gjykatat e rregullta nuk e kanë lejuar ekspertizën e sërishme të të dhënave të telefonave celularë të parashtruesve; (b) se nuk i kanë pranuar si prova të reja deklaratat e dëshmitarëve të dhëna nën betim para noterit; (c) se gjykatat nuk i kanë shqyrtuar provat në lidhje me alibinë e parashtruesve; (d) se gjykatat nuk e kanë marrë parasysh ligjin më të favorshëm me rastin e shqiptimit të aktgjykimet; (e) se e kanë aplikuar ligjin e gabuar me rastin e shqiptimit të dënimit.
21. Më tej, parashtruesit theksojnë se gjykatat e rregullta kanë vendosur dhe vlerësuar provat sipas së “drejtës diskrecionale” gjë që nuk kanë pasur të drejtë ta bëjnë, duke vendosur “sipas bindjes së lirë” pa mbajtjen e seancës në të cilën administrohen provat, dhe kështu e kanë shkelur një numër të madh të neneve të Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Penal të Kosovës.
22. Parashtruesit më tej pretendojnë se vendimet e gjykatave të rregullta janë “arbitrare dhe të kundërligjshme”, sepse atyre u janë shqiptuar dënimet e parashikuara për personat e rritur, edhe pse parashtruesit në momentin e kryerjes së veprës ishin të miturit e rritur.
23. Në fund, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se “është shkelë e drejta e tyre, sipas neni 6 të Konventës Evropiane të Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), dhe neni 31 i Kushtetutës së Kosovës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e me theks të veçantë paragrafi 7 i këtij neni ku parashihen procedurat e veçanta për të miturit, në rastin konkret të miturit e rritur sipas KPM. Pasi që në këtë rast që të tri instancat përfshi edhe Mjetin e jashtëzakonshëm, kanë marrë vendimin në shpërputhshmëri me ligjin e aplikueshëm siç u cek më lart nga neni 34 paragrafi 2 i KPM (Ligji i zbatuar

në Kosovë midis 22 marsit 1989 dhe 12 dhjetorit 1999, Rreg. e UNMIK-ut, 1999/24 hyri në fuqi), dhe Neni 385.1.4. KPPK „lidhur me veprën e gjykuar penale është zbatuar ligji që nuk mund të zbatohet”.

24. Për shkak të asaj që u tha më sipër, parashtruesit e kërkesës konkludojnë se është “pamundësuar e drejta për rishikimin e procedurës së përfunduar me aktgjykim të formës së prerë” dhe se Gjykata duhet të anulojë vendimet e gjykatave të rregullta si kundërkushtetuese dhe të “mundësohet rishikimi i procedurës (me forcën ligjore) për arsyet që u cekën më lart”.
25. Parashtruesit e kërkesës propozojnë që “Gjykata të konstatojë se gjykatat e rregullta [...] kanë cenuar të drejtat e procesit të rregullt ligjor të Parashtruesve të kësaj kërkesë sipas parimit të drejtësisë siç parashihet në nenin 6 të KEDNJ dhe nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit ky panel të konstatojë se në vendimet e përshkruara të dy Gjykatave të rregullta përfshi këtu edhe Kërkesën e Mbrojtjes së Ligjshmërisë si mjet të jashtëzakonshëm nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës, janë të kundërligjshme”.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të parapara më tej me Ligj dhe të specifikuar me Rregullore të punës.
27. Në lidhje me këtë, Gjykata gjithashtu i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

28. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.”
29. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuar, i kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion dhe kanë parashtruar kërkesën në kohë.
30. Megjithatë, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

31. Përveç kësaj, Gjykata i referohet paragrafit (3) (e) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:

[...]

(e) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;

32. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se atyre u ishte mohuar e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm në procedurat para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme në lidhje me kërkesën për rishikimin e rastit të tyre.

33. Gjykata rikujton nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili parasheh që:

(2) Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

34. Gjykata, gjithashtu, rikujton nenin 6 të KEDNJ-së, i cili parasheh që:

(1) Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.

35. Përveç kësaj, Gjykata rikujton praktikën konsistente gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), e cila përcakton se:

“[GJENDJ] rikujton se sipas praktikës së vendosur gjyqësore, neni 6 nuk zbatohet në procedurat për rishikimin e procedurës penale sepse një person i cili bën kërkesë për rishikimin e rastit të tij dhe dënimi i të cilit është bërë i plotfuqishëm, nuk është “akuzuar për vepër penale” brenda kuptimit të nenit 6 (shih Vendimin e GJEDNJ-së për papranueshmëri të 5 shkurtit 2004, Erdemli kundër Turqisë, nr. 33412/03; dhe Vendimi i GJEDNJ-së për papranueshmëri i 6 majit 2003, Fischer kundër Austrisë, nr. 27569/02).”

36. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës janë dënuar në shkallën e fundit sipas akuzave penale, dhe kërkesa e tyre për mbrojtjen e ligjshmërisë në lidhje me ato procedura ishte refuzuar nga Gjykata Supreme më 1 shkurt 2011.

37. Gjykata gjithashtu rikujton se parashtruesit e kërkesës kishin dorëzuar një kërkesë, të regjistruar me numrin KI81/11, duke pretenduar se gjykatat e rregullta kishin shkelur të drejtën e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm gjatë vendosjes lidhur me akuzat penale kundër tyre, dhe se Gjykata e kishte refuzuar atë kërkesë më 15 maj 2012, si të papranueshme sepse ishte qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.
38. Gjykata vëren se kërkesa e tanishme ka të bëjë me procedurat në lidhje me një kërkesë për rishikimin e procedurës penale, të cilat ishin iniciuar nga parashtruesit e kërkesës diku para 4 shtatorit 2015.
39. Gjykata konsideron se procedurat lidhur me kërkesën e parashtruesve për rishikimin e procedurës nuk kanë të bëjnë me vendosje për një akuzë penale në kuptim ose të nenit 31 (2) të Kushtetutës ose të nenit 6 (1) të KEDNJ-së.
40. Si të tilla, procedurat e kontestuara nuk hyjnë brenda fushëveprimit të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.
41. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesve të kërkesës nuk janë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
42. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36, paragrafi (3) (e) i Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113, paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 46 të Ligjit dhe rregullit 36 (3) (e) të Rregullores së punës, më 6 shtator 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi